



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2905/7 prot.

Datë 13.11.2024

V E N D I M
Nr. 1599/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.11.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” D.Sh.H, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. **REF- 18925-09-12-2024**, me objekt “*Rikonstruksion rruga e Malësorëve, Njësia Administrative Bushat*”, me vlerë **14,301,239** (katërmbëdhjetë milion e treqind e një mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 30.09.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” D.Sh.H me NIPT L04803001U dhe adresë: Njësia Nr. 8, Rruga Xhorxhi Martini, Nr. 20, Godinë Nr.11-katëshe, Shkalla 2, kati 7, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vau Dejës me adresë: Rruga “Qafa e Gurit” Vau Dejës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

1.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.09.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. **REF- 18925-09-12-2024**, me objekt “Rikonstruktion rruga e Malësorëve, Njësia Administrative Bushat”, me vlerë **14,301,239** (katërmbëdhjetë milion e treqind e një mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 30.09.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës..

II.2. Në datën 30.09.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 03.10.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "M U R A T I"	12,525,500.00 lekë pa Tvsh	I Skualifikuar
2. ALB TIEFBAU	13,156,189.00 lekë pa Tvsh	I Skualifikuar
3. K.M. KONSTRUKSION	11,615,038.00 lekë pa Tvsh	I Skualifikuar
4. LAÇAJ	11,970,044.00 lekë pa Tvsh	I Kualifikuar
5. NDERTUESI 2000	12,268,760.00 lekë pa Tvsh	I Kualifikuar
6. NDERTUESI 2014	11,863,560.00 lekë pa Tvsh	I Kualifikuar
7. RSM COMPANY	10,253,990.00 lekë pa Tvsh	I Skualifikuar
8. VARAKU E	12,996,095.00 lekë pa Tvsh	I Skualifikuar

II.4. Në datën 04.10.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 67, datë 07.10.2024, ku fitues është shpallur operatori ekonomik NDERTUESI 2014 shpk.

II.5. Operatori ekonomik “ RSM COMPANY” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

- *Operatori ekonomik nuk ka kontrate me landfillin.*

II.6. Në datën 10.10.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4646, si dhe nr. protokollit 2905/2024 datë 10.10.2024 e operatorit ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” D.Sh.H, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2905/2 prot., datë 10.10.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 2905/2024 prot., datë 10.10.2024.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 6421 prot., datë 22.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 2905/3 prot., datë 24.10.2024, me objekt “Dërgim i Vendimit të Kryetarit nr.45, datë 22.10.2024” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor

informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 6411 prot., datë 22.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 2905/4 prot., datë 28.10.2024, me objekt “Vendim” dërguar me sitemin elektronik të ankesave, është dërguar nga autoriteti kontraktor, informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” D.Sh.H, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “.....Operatori ekonomik nuk ka kontrate me landfillin.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën e ndryshuar të datës 23.09.2024, të dokumentave të tenderit pika 2.7, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtohet pika 2.7

2.7 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale të mëposhtme:

Licencë nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve”.

- *Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë me një landfill të vlefshme, Vendi i depozitimit duhet te jete brenda territorit administrativ te qarkut Shkoder.*

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë::

-Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” D.Sh.H,

-Deklaratë me datë 30.09.2024 të OE “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” D.Sh.H, ku ka cituar se “Marrim persiper qe te kryejme grumbullim dhe transportin e

mbetjeve ne nje landfill te ndryshem nga ai qe keni kerkuar ju, duke e realizuar kete me shpenzimet tona”;

-Deklaratë angazhimi me datë 30.09.2024 nga subjekti “AVDULI” shpk, ku është subjekt mbështetës i operatorit ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” D.Sh.H, për Licencë kodi III.2.B;

- Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit të subjektit mbështetës “AVDULI” shpk;

-Licencë me nr. Serial LN-2504-01-2017, kodi III.2.B, të subjektit mbështetës “AVDULI” shpk;

-Akt-Miratimi për Licencën e kategorisë III.2.B të subjektit mbështetës “AVDULI” shpk;

-Miratim të kodit unik për transportin e mbetjeve jo të rrezikshme për subjektin mbështetës “AVDULI” shpk;

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” , të ndryshuar, parashikon se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të

zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.6. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e punëve” pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, se nuk e përmbush kriterin më sipër konkretisht pikën 2.7 “Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat profesionale të mëposhtme: Licencë nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve”. Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë me një landfill të vlefshme, Vendi i depozitimit duhet të jete brenda territorit administrativ të qarkut Shkoder, duke pretenduar në ankesë se Per aq kohe sa ne e disponojme kete license QKL Kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve” nuk ka arsye qe te lidhim dhe nje kontrate shtese me se zben brenda territorit te Bashkise Shkoder pasi qellimi i Autoritetit Kontraktor eshte plotesuar..... per ti dhene siguri autoritetit kontraktor kemi deklaruar se marrim persiper qe te kryejme grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve ne nje landfill te ndryshem nga ai qe ka kerkuar, duke e realizuar kete proces me shpenzimet tona, deklarate e cila duhej te merrej ne konsiderate pasi ne si shoqeri kerkesen minimale per QKL e kemi plotesuar. Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumnetacionin provues të cituar në pikën III.1. 2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, përgjigjes së autoritetit kontraktor si dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni gjykon se, operatorit ekonomik ankimues nuk ka dorëzuar asnjë dokument ku të provojë se ka një kontratë me një landfill të vlefshme, ku vendi i depozitimit duhet të jete brenda territorit administrativ të qarkut Shkoder. Për më tepër, vetë operatori ekonomik ankimues pranon se nuk ka arsye qe te lidhim dhe nje kontrate shtese me se zben brenda territorit te Bashkise Shkoder, si dhe kryejme grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve ne nje landfill te ndryshem nga ai qe ka kerkuar, duke krijuar bindjen që ky i fundit nuk ka ngakuar në sistemin eprokuirimit elektronik asnjë dokument në përmbushje të kriterit 2.7 të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër, rezulton, se operatori ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” D.Sh.H, është në kushtet e mospërmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon kontratës me një landfill të vlefshme, Vendi i depozitimit duhet të jete brenda territorit administrativ të qarkut Shkoder sepse nga ana e këtij operatori ekonomik në sistemin e prokurimit elektronik nuk është dorëzuar asnjë dokument që vërteton plotësimin e kërkesës së mësipërme të autoritetit kontraktor. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara

nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” D.Sh.H, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. **REF- 18925-09-12-2024**, me objekt “*Rikonstrukcion rruga e Malësorëve, Njësia Administrative Bushat*”, me vlerë **14,301,239** (katërmbëdhjetë milion e treqind e një mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 30.09.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” D.Sh.H.,
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

